



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 9012 prot.

Himarë, më 17.12.2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të Udhëzimit nr. 14, datë 21.03.2006 “Për procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale në administratën publike” në kuadër të Programit URBACT (URBACT Pioneers Accelerator) të financuar nga BE Bashkia Himarë, njofton shpalljen për:

1 vend të lirë pune me afat të caktuar sipas aktiviteteve të programit URBACT (URBACT Pioneers Accelerator VI “Nxitës Pionier” (Intern): Si praktikant për praktikë të paguar, në Bashkinë Himarë në kuadër të programit URBACT të financuar nga BE.

Në kuadër të pjesëmarrjes së Bashkisë Himarë në projektin “Nxitës Pionier / Pioneer Accelerator” të programit URBACT IV shpallet thirrja për aplikim për pozicionin Praktikant në projektin “Nxitës Pionier” të programit URBACT IV, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve lokale të projektit dhe forcimin e kapaciteteve në fushën e komunikimit, përfshirjes së aktorëve lokalë dhe dokumentimit të përvojave të fituara.

OBJEKTIVI I POZICIONIT

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore
 - Kandidati/ja i/e përzgjedhur do të ketë këto detyra:
 - Pjesëmarrje aktive në ëorkshop-e, sesione të mbledhjes së ideve dhe nevojave sipas kontekstit të bashkisë Himarë dhe aktivitete që lidhen me adresimin e sfidës urbane të identifikuar nga Bashkia Himarë.
 - Mbështetje në zbatimin e strategjisë së komunikimit të projektit, përfshirë shkrimin, redaktimin dhe publikimin e përmbajtjes multimediale në kanalet digjitale të URBACT dhe të Bashkisë Himarë.
 - Ndihmë në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve lokale, si: takime dhe aktivitete të përfshirjes së palëve të interesuara.
 - Kontribut në përgatitjen e materialeve të komunikimit digjital dhe të printuar.
 - Mbështetje në dokumentimin e përvojave dhe rezultateve të projektit përmes Ditarit Dinamik (Dynamic Journal – DJ).
2. Pjesëmarrje në takimet online dhe të drejtpërdrejta: Masterclass, evente Milestone dhe, sipas mundësive, në të paktën një vizitë studimore, në përputhje me udhëzimet e URBACT IV.

3. Kriteret e Kualifikimit

Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Student/e ose i/e diplomuar në fushat: urbanistikë, arkitekturë, planifikim urban, shkencë sociale, komunikim, marrëdhënie ndërkombëtare ose fusha të ngjashme.
- Interes i shprehur për zhvillimin urban, qeverisjen vendore dhe projektet evropiane.
- Aftësi të mira komunikimi dhe shkrimi.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.
- Aftësi për të punuar në ekip dhe për të mbështetur procese bashkëpunuese.

4. Kohëzgjatja dhe forma e angazhimit

- Kohëzgjatja: 8 muaj
- Forma e angazhimit: Me kohë të pjesshme
- Vendi i angazhimit: Bashkia Himarë me aktivitete në terren.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumente/219-udhezime-dokumente>
- CV (në gjuhën shqipe ose angleze)
- Letër interesi (maksimumi 1 faqe)
- Fotokopje të diplomës dhe lista e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Certifikatë familjare;
- Certifika personale;
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për fazën e mëtejshme të përzgjedhjes.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, ose në adresën e e-mailit: info@himara.gov.al brenda dates 31.12.2025.

KRYETARI
Vangjel Tavo

